



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 10 dhjetor 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1339\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 16, Nenin 25 dhe Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 26 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085),
- Nenin 24 të Ligjit për Energjinë,
- Vendimit të Bordit të ZRRE-së të datës 30 mars 2011 lidhur me kriteret për vlerësimin e konkurrencës në furnizim me energji elektrike,

**në seancën e mbajtur me datë 10.12.2020 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** - dokumenti "Vlerësimi i konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë 2018-2019".
- II.** Sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e ZRRE-së V\_342\_2011, si dhe rezultatet e përfituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimit të Tregut (HHI), nuk ekziston konkurrencë efektive në tregun e energjisë në vend për periudhën e analizuar 2018-2019.

## **A r s y e t i m**

- Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në kërkesat ligjore ka zhvilluar dokumentin "Vlerësimi i konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë 2018-2019", i cili përfshin kriteret e përcaktuara në Vendimin e ZRRE-së V\_342\_2011, rezultatet e fituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimit të Tregut (HHI) dhe rezultatet e fituara nga anketa e zhvilluar me furnizuesit e licencuar në Kosovë lidhur me nivelin e konkurrencës në treg.
- Sipas gjendjes së tregut të energjisë me shumicë për periudhën 2018-2019, Indeksi HHI rezulton të jetë 9115, që tregon se përqendrimi i tregut është shumë të lartë.
- Në periudhën e vlerësuar janë tetë (8) furnizues të licencuar për furnizim me pakicë, por vetëm njëri nga ta (KESCO) ushtron aktivitetin e tij dhe ka 100% të pjesëmarrjes në treg, dhe



si rezultat i kësaj Indeksi HHI ka vlerën 10000, që poashtu tregon se përqendrimi i tregut me pakicë është shumë i lartë.

- Duke u nisur nga kriteret e përcaktuara në Vendimin e ZRRE-së V\_342\_2011, vlerat e treguesve të indeksit HHI dhe anketën e zhvilluar me pjesëmarrësit në treg, ZRRE konstaton se përqendrimi i tregut të energjisë me shumicë dhe atij me pakicë është shumë i lartë, që nënkupton se tregu i energjisë në vend për periudhën e analizuar 2018-2019 nuk ka konkurrencë efektive.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit ka vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat procedurale, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi nr. V\_880\_1\_2017 i aprovuar nga Bordi i ZRRE-së.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Shtojcë:** dokumenti "Vlerësimi i konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë 2018-2019"

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

  
Arsim Janova, u.d. kryesuesit

  
Besim Sejftaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar